

Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

“Politikat mbështetëse për Bujqësinë Organike në BE dhe në Shqipëri Edvin Zhllima

Projekti “Përmirësimi i njohurive të fermerëve të bujqësisë organike në lidhje me procesin e Integrimit Evropian”

Ky projekt bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet IPA II European Union Integration Facility 2014 "Mbështetje e organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e ngritjes së kapaciteteve për aksione që do rrisin dialogun e politikave dhe ndërgjegjësimin për integrimin në Bashkimin Evropian", i cili menaxhohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (CFCU) dhe zbatohet nga IPSED në partneritet me organizatën ISP.

Përmbajtja

1. Qasja ndaj Bujqësisë Organike sipas BE:
 - A. Njohja me rregullat e prodhimit organik
 - B. Çertifikimi
 - C. Periudha në kalim
 - D. Politikat Mbështetëse
2. PPB pas 2020
 - A. 9 objektivat e PPB së ardhshme
 - B. Prioritetet e PPB së ardhshme
 - C. Ndikimi tek mjedisi dhe ndryshimet klimatike
3. Politikat mbështetëse për fermat organike në Shqipëri
 - A. Mbështetja sipas skemave kombëtare
 - B. Mbështetja sipas IPARD II



Pjesa I

Qasja ndaj Bujqësisë Organike sipas BE



Njohja me rregullat e prodhimit organik

- Të prodhosh produkte organike do të thotë të respektosh parimet, rregullat dhe kërkesat për bujqësinë organike.
- Kushdo që dëshiron të bëhet një fermer organik duhet të sigurohet që njeh legjislacionin e nevojshëm në mënyrë që të jetë plotësisht i vetëdijshëm për përgjegjësitë e tij.
- Para se të filloni ndonjë aktivitet në sektorin organik, duhet të kontaktoni autoritetin kompetent në vendin tuaj (p.sh. Ministrinë e Bujqësisë). Ata mund t'ju japin informacione mbi masat mbështetëse në dispozicion dhe këshilla më të përgjithshme.



Çertifikimi

- Të gjithë prodhuesit, përpunuesit ose tregtarët që dëshirojnë të tregtojnë produktet e tyre si organike, duhet të regjistrohen në një agjenci certifikuese / trup certifikimi dhe kontrolli.
- Kjo agjenci është përgjegjëse për të verifikuar se operatori vepron në përputhje me rregullat e prodhimit organik.
- Nëse dëshironi të bëheni një fermer organik, duhet të jeni të certifikuar nga një agjenci kontrolli (trup certifikimi dhe inspektimi).
- Kjo përfshin inspektimin vjetor dhe një seri kontrollesh për t'u siguruar që po respektoni rregullat mbi prodhimin organik.



Trupat certifikues

- Çdo vend në BE emëron një 'autoritet kompetent' i cili është përgjegjës për të siguruar që rregullat e organikëve të BE-së ndiqen.
- Zakonisht këto janë ose një departament i bujqësisë ose një departament i shëndetit publik.
- Ky autoritet kompetent mund të delegojë rolin e tij një ose më shumë organe private të kontrollit një ose më shumë autoritete të kontrollit publik një sistem i përzier me organet e kontrollit privat dhe autoritetet e kontrollit publik
- Pavarësisht nga sistemi i zgjedhur, autoriteti kompetent është përgjegjës për auditimin e sistemit të inspektimit brenda zonës së tij të përgjegjësisë.
- Një herë në vit, vendet e BE raportojnë në Komisionin Evropian për rezultatet e kontroleve të kryera mbi operatorët organikë dhe për masat e marra në rast mosrespektimi.
- Shihni këto adrese për listen e trupave certifikues>
https://ec.europa.eu/agriculture/ofis_public/r8/ctrl_r8.cfm?targetUrl=home&lang=en

Kontrollet në praktikë

- Fermerët, përpunuesit ose tregtarët duhet të kontrollohen nga një autoritet kontrolli përpara se të mund të shesin produktet e tyre si organike.
- Fermerët duhet të respektojnë një sërë elementesh të legjislacionit sektorial që mbron shëndetin publik, shëndetin e kafshëve dhe bimëve, mjedisin dhe mirëqenien e kafshëve.
- Të gjithë fermerët që marrin ndihmë u kërkohet të zbatojnë kërkesat ligjore për menaxhim (SMR) në bazë të legjislacionit të pajtueshmërisë ndër-e cila reflekton respektimin e tyre për ligjin e BE-së për ushqimin dhe mjedisin.
- Të gjithë prodhuesit e ushqimit duhet të respektojnë ligjin e përgjithshëm të ushqimit i cili përfshin legjislacionin për etiketimin.
- Produktet specifike mund të kenë rregulla shtesë, siç janë kërkesa për etiketime më të detajuara.

Periudha në kalim

- Çdo fermë që dëshiron të prodhojë në mënyrë organike duhet t'i nënshtrohet një procesi të njohur si 'periudha në kalim'.
- Gjatë kësaj periudhe, metodat e prodhimit organik duhet të përdoren, por produkti që rezulton nuk mund të shitet si organik.
- Zgjatja e kësaj periudhe kalimi varet nga lloji i produktit organik që prodhohet
 - 3 vjet për pemtoret dhe vreshtat
 - 12 muaj për tokat e kullotjes për derrat dhe shpendët (pulat)
 - 2 vjet për tokat e kullotjes për të imtat



Periudha në kalim

- Periudha në kalim mund të jetë një periudhë e vështirë për fermat organike, sepse metodat organike shpesh rezultojnë në **rendimente më të ulëta**, ndërsa në të njëjtën kohë produktet e prodhuara gjatë periudhës së konvertimit nuk mund të përfitojë të njëjtin **çmim premium**.
- Për të kultivuar produktet gjatë periudhës në kalim farat duhet të jenë organike.
- Për këtë arsye, vendet e BE-së ofrojnë masa të ndryshme mbështetëse për të ndihmuar fermerët që të kalojnë në bujqësinë organike.



Politikat Mbështetëse për fermerët organikë në BE (1)

- Mbështetja financiare e BE-së ofrohet edhe për periudhën në kalim por edhe pas saj (për të qëndruar në statusin e prodhimit organik).
- BE gjithashtu ndihmon fermerët të krijojnë organizata prodhuese që ndihmojnë në mbrojtjen kundër praktikave të padrejta tregtare dhe gjithashtu i ofron mbështetje gjatë luhatjeve të tregut.
- Në BE fermerët organikë gjithashtu mund të përfitojnë nga këshilla për praktikat më të mira ose se si të aplikojnë metoda të reja dhe inovative.
- Fermerët organikë gjithashtu mund të aplikojnë për forma të tjera të mbështetjes në bazë të Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB).



Politikat mbështetëse në BE për fermat organike nën PPB (2)

- Normat e pagesave për konvertim
 - Varen nga lloji i kulturës së mbjellë. Psh. 1 ha tokë e punueshme ka një pagesë konvertimi nga 77-600 euro. Kurse 1 ha tokë për vreshta ka një pagesë për konvertimin 350-1080 euro.
 - Disa nga kriteret/kërkesat janë: mbajtja e shënimeve të të dhënave mbi fermën, trajnime të vazhdueshme, reduktimi i përdorimit të plehut me nitrogen, ndalimi i kultivimeve paralele, ndalimi i konvertimit nga kullota të përhershme në toka të punueshme etj.
- Mbështetja për certifikimin (varet nga vendi)
 - Disa vende mbështesin një pjesë/dis a pjesë të certifikimit dhe inspektimit kurse disa vende të tjera kanë pagesa fikse si psh mbështetësin me një sasi parash të caktuar për fermë, për hektar ose si % ndaj kostove të certifikimit dhe inspektimit



Politikat mbështetëse në BE për fermat organike nën PPB (3)

- Fermerët organikë kualifikohen automatikisht për **pagesa agro-mjedisore**.
- Këto pagesa u krijuan për të inkurajuar fermerët të marrin vendime me ndikim pozitiv tek mjedisi.
- Gjithashtu këto pagesa pasqyrojnë përfitimet e shumta që ka bujqësia organike për mjedisin.
- Ekzistojnë dhe kombinime
 - Psh. masa të mbrojtjes së ujit, të tokës, ruajtjen e karakteristikave të peizazhit, tipet tradicionale të kulturave, inkurajimi i aktiviteteve turistike etj.



Pjesa II

Politika e Përbashkët Bujqësore (PBB) pas 2020




9 objektivat e PPB pas 2020

1. Sigurimi i shpërndarjes së drejtë të të ardhurave për fermerët
2. Rritja e konkurrencës
3. Rikuperimi i fuqisë në zinxhirin agro-ushqimor
4. Adresimi i ndikimit në ndryshimet klimatike
5. Mbrojtja e mjedisit
6. Ruajtja e peisazheve dhe biodiversitetit
7. Mbështetja e fermerëve të rinj
8. Gjallërimi i zonave rurale
9. Mbrojtja e shëndetit dhe cilësisë së ushqimit



Skema e 9 Objektivave të PPB pas 2020



Prioritetet e PPB së ardhshme

- Për të siguruar qëndrueshmëri dhe parashikueshmëri, mbështetja e të ardhurave do vazhdojë të jetë një pjesë e rëndësishme e PPB pas 2020.
- PPB e re i jep prioritet fermerëve të rinj (të vegjël dhe mesatar)
 - ✓ Rritja e nivelit të mbështetjejeve për hektar për fermat e vogla dhe të mesme
 - ✓ Zvogëlimi i pjesës së pagesave direkte të përfituara mbi 60,000 € dhe 100,000 € për fermë, me qëllim të sigurimit të një shpërndarjeje më të drejtë të pagesave.



Prioritetet e PPB së ardhshme

- Lehtësimi i jetesës së fermerëve të certifikuar
 - A. duke rritur qartësinë për rregullat ligjore dhe
 - B. duke lejuar harmonizimin e mëtejshëm dhe thjeshtësimin e rregullave të prodhimit.
- Rritja e besimit të konsumatorit duke forcuar sistemin e kontrollit.
- Rregullorja e re redukton barrën administrative për operatorët dhe trupat kontrollues dhe inspektues.



Rregulla të reja të PPB së ardhshme

- Zgjerimi i rregullave për prodhimin organik për të mbuluar një listë më të gjerë të produkteve (p.sh., kripë, dyllë blete, gjethet e hardhive etj.) dhe rregulla shtesë të prodhimit (p.sh. dreri, lepujt dhe pulat).
- Mbështetje për fermerët e vegjël duke futur një sistem të ri të certifikimit të grupeve.
Kjo do të lehtësojë fermerët e vegjël të kalojnë në bujqësinë organike duke zvogëluar shpenzimet e inspektimit dhe certifikimit, si dhe barrën administrative përkatëse.
- Ofrimi i një qasje më uniforme për pesticidet. Rregullorja e re harmonizon masat paraprake duke rritur sigurinë ligjore.



Mjediti dhe ndryshimet klimatike –PPB pas 2020

- Fermerët luajnë një rol kryesor në adresimin e ndryshimit të klimës, mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e peizazheve dhe biodiversitetin.
- Disa nga kërkesat e BE janë:
 - Ruajtja e tokave të pasura me karbon përmes mbrojtjes së kullotave për të përmirësuar cilësinë e ujit, për të zvogëluar nivelin e oksidit të amoniakut etj.
 - Qarkullim të të mbjellave në vend të diversifikimit
- Fermerët do të kenë mundësinë të kontribuojnë më tej dhe të shpërblehen për tejkalimin e kërkesave të detyrueshme.
- Vendet e BE-së do të zhvillojnë skema ekologjike vullnetare për të mbështetur dhe stimuluar fermerët të aplikojnë praktika bujqësore të dobishme për klimën dhe mjedisin.




Pjesa III

Politikat mbështetëse për fermat organike në Shqipëri



Vlera e mbështetjes buxhetore

Mbështetja buxhetore në vlerë dhe si pjesë e GVA së bujqësisë në periudhën 2005-2018




Source: APM database - Albania 2019; Agricultural statistics database - Albania 2019

- Mbështetja është nën 2% e GVA dhe nuk përmbush kërkesën për aksesimin (afërsisht 10% e GVA)

Vlera e mbështetjes sipas kategorive per Shqiperine (ne Mln Euro)

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Masat për mbështetjen e tregut dhe ato direkte per prodhuesit	1.2	2.0	0.9	0.4	1.6	2.0	3.0	5.3	4.6	4.8	3.1
Masat për zhvillimin strukturor dhe rural	7.6	20.2	15.0	20.5	16.6	9.9	10.7	21.3	29.0	19.0	29.6
Të tjera masa	3.6	4.4	3.1	6.0	5.5	8.1	9.2	5.9	11.0	6.7	10.3
Mbështetja totale buxhetore për bujqësinë	12.4	26.6	19.0	26.8	23.6	20.1	23.0	32.4	44.6	30.6	43.0

Kategoritë e mbështetjes si pjesë e GVA-së së Bujqësisë për vitin 2018 (%)




Kategoritë e mbështetjes si pjesë e GVA-së së Bujqësisë për vitin 2018 (%)

	Masat për mbështetjen e tregut dhe ato direkte për prodhuesit	Masat për zhvillimin strukturor dhe rural	Të tjera masa	Totali i mbështetjes
Shqipëria 2018	0.2	1.2	0.4	1.8
Bosnja dhe Herzegovina	3.3	0.1	0.2	3.6
Kosova	3.5	1.5	1.1	7.4
Maqedonia	6.9	1.3	1.6	9.8
Mali i Zi	1.5	2.3	3.0	4.8
Serbia	2.3	0.7	0.8	3.8
Mesatarja Ballkan	2.9	1.2	1.2	5.2
Mesatarja BE	13.0	6.0	3.5	22.5

Kategoritë e mbështetjes në vlerë për sipërfaqe

Përbërja e mbështetjes buxhetore në Shqipëri, vende të Ballkanit dhe BE në Euro për Ha Sipërfaqe Bujqësore të Punueshme (për vitin 2018)



Kategoritë e mbështetjes në vlerë për sipërfaqe (për vitin 2018)

	Masat për mbështetjen e tregut dhe ato direkte për prodhuesit	Masat për zhvillimin strukturor dhe rural	Të tjera masa	Buxheti total
Shqipëri 2018	3	31	11	45
Mesatare Shqipëri 2011-2018	3	20	8	30
Bosnjë Hercegovinë	60	3	3	66
Kosovë	69	36	18	123
Maqedoni	143	27	18	189
Mali i Zi	29	51	14	94
Serbia	47	15	7	69
Mesatarja Ballkan	54	21	10	86
Mesatar BE	274	135	37	446

Arsye për rritjen buxhetore

Krahasuar me Ballkanin:

- Shqipëria 1.8% e GVA së bujqësisë kur Ballkani është 5% of GVA
- Shqipëria më e ulta me më pak se 45 Euro për Ha SBP kur mesatarja e Ballkanit është 86 Euro/Ha SBP

Kërkesa e BE: Vendi kandidat duhet të ketë një buxhet për bujqësinë sa 1/3 e asaj që pret të përfitojë pas anëtarësimit (pra rreth 10 % te GVAsë)

- Shqipëria 25 Mln Euro mesatarisht në vitet e fundit dhe 40 Mln të 2019 por na nevojitet 5 herë më tepër, pra 150-200 Mln Euro.

Të tjera arsye për rritjen buxhetore

1. Pamundësia për mbështetje të palidhur me prodhimin duhet korigjuar prandaj kërkon vlerë buxhetore të lartë
2. Kërkohet mbështetja e sektorëve që ruan balancat demografike (te imtat, gjedhi, aroret, mjalti dhe BMA te egra) dhe krijon konkurrueshmeri (bimet e serave, frutat, BMA e kultivuara, etj).
3. Nevoja buxhetore për arritjen e standarteve të sigurisë ushqimore dhe standarteve për tregun e huaj (Global Gap, etc)
4. Mundësia për të ruajtur masa të caktuara mbështetjes të lidhura me prodhimin si Masa të Mbështetjes Vullnetare (psh për të imtat) e që më pas mund të negociohen mbi principin e vitit prag.

Politikat mbështetëse për fermat organike (skemat kombëtare)

- Në bujqësinë organike ka pasur një rritje të subvencioneve nën skemat direkte
 - 80,000 lek për fermë të certifikuar në vitin 2016
 - 200,000 lek në vitin 2017
- Kultivuesit e ullirit kanë përfituar në mënyrë indirekte nga skema e mbështetjes për të mbrojtur ullinjtë nga miza (*Bractocera olea*).
- Në vitin 2018, fermat organike kanë përfituar për periudhën në kalim:
 - vitin e parë, në vlerën 100,000 lekë,
 - në vitin e dytë 150,000 lekë dhe
 - 200,000 lekë, për fermë të certifikuar



Subvencionimi i ofruar në vite nga skemat kombëtare

Viti	Vlera e subvencionit në lek	Përshkrimi
2008	6,000-70,000	50% e kostos së certifikimit por jo më shumë se 6000 lek për tregun Shqiptar dhe 70000 lek për eksport
2009	20,000-70,000	50% e kostos së certifikimit por jo më shumë se 20000 lek për tregun Shqiptar dhe 70000 lek për eksport
2010	50,000	Sasi fikse për të gjitha fermat
2011	70,000	Sasi fikse për të gjitha fermat
2012	70,000	Sasi fikse për të gjitha fermat
2013	70,000	Lekë/fermë
2014	80,000	Lekë/fermë të certifikuar
2016	80,000	Lekë / fermë të certifikuar
2017	200,000	Lekë / fermë të certifikuar
2018	200,000	Fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100,000 lekë, në vitin e dytë 150,000 lekë dhe 200,000 lekë, për fermë të certifikuar

IPARD II

Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit

- 7.1 Sigurimi dhe prodhimi i bimëve medicinale dhe aromatike, kërpudhave, mjaltit, kërmijve dhe materialeve për prodhimin e vajrave esenciale
- 7.3 Përpunimi dhe tregtimi i bimëve medicinale dhe aromatike të egra apo të kultivuara, kërpudhave, vaji i ullirit, mjalti, peshku dhe produktet e peshkut, prodhimi dhe marketingu i vajrave esenciale
- Masa 7: Buxheti total 8.30 milion EURO, me një minimum prej 10 000 EURO, maksimumi 400 000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 65% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.



Kategoritë e shpenzimeve të pranueshme

Masa 7.1 Prodhimi i bimëve medicinale dhe aromatike, këpurdhave, mjaltit, bimëve dekorative, kërmijëve

- BMA-të dhe bimët dekorative;
 - ambiente për prodhim, sera (ambiente të mbuluara me xham dhe/ ose tunele plastikë me garanci të paktën 5 vjet), përfshirë hapsira dhe pajisje për ventilim, ajër të kondicionuar dhe ngrohje, sisteme alarmi me gjeneratorë elektrikë, cisterna uji dhe sisteme ujitje;
 - pajisje të specializuara për prodhime në hortikulturë dhe ferma fidanishtesh, përfshirë traktorë deri në 70 kw;
 - ambiente dhe pajisje për pas vjeljen, për grumbullim/ajrosje, tharje dhe ruajtje.
- Mjalti
 - koshere, pajisje për kosheret, pajisje mbrojtëse, tymuese dhe pajisje të tjera për prodhimin e mjaltit; pajisje për mbarështimin e bletëve;
 - strehë(ambiente) dhe pajisje për nxjerrjen dhe ruajtjen e mjaltit, produktet e bletarisë dhe pajisje për prodhimin;
 - pajisje laboratorike;
 - pajisje për prodhimin dhe përgatitjen e ushqimit suplementar të bletëve ;
 - ngritja e rrethimit përreth fermës së bletëve/koshereve .
- Fermat e kërmijëve
 - ambiente dhe pajisje të specializuara për mbarështimin, rritjen, mirëmbajtjen dhe ruajtje;
- Kultivimi i kërpudhave
 - ambiente dhe pajisje, sisteme kondicionimi (për temperaturën, ventilimin, ndriçimin, lagështirën, etje.) për prodhimin, ruajtjen dhe ftohjen;
 - ambiente dhe pajisje për prodhimin e kompostos .

Kategoritë e shpenzimeve të pranueshme

Masa 7.3 Përpunimi dhe tregtimi i bma-ve të egra ose të kultivuara, kërpudhave, vajit të ullirit, mjaltit, produkteve prej peshkut ose peshkimit, prodhimi dhe tregtimi i vajrave esenciale

- 7-3.1 Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i ambienteve dhe pajisje për përpunimin
- Qëndrat e grumbullimit dhe ambjente për lëndët e para;
- ambiente dhe pajisje (përfshirë pasjisje dhe programme të specializuara kompjuterike) për përpunimin e produkteve finale dhe nën/produkteve, përfshirë vendosjen e kushteve mikroklimaterike të veçanta dhe/ose të temperaturës për nevojat e prodhimit;
- laboratorë të brendshëm për cilësinë e produkteve, analizat e higjienës dhe sigurisë ushqimore;
- ambjente dhe pajisje për ruajtjen e produkteve ,përfshij krijimin e kushteve të veçanta mikroklimaterikedhe/ose kushtet e temperaturës;
- ambiente dhe pajisje për ruajtjen e nën/produkteve, me origjinë nga shtazore dhe bimët për jo për konsum njerëzor;
- Makineri dhe pajisje për manovrimin dhe transportin e produkteve dhe nën/produkteve;
- pajsisje dhe makineri për trajtimin e mbetjeve dhe ujërave të ndotura;
- ambiente sanitare për personelin dhe mjdisë për mbajtjen e pasjisje të pastrimit, larjes dhe agentëve dezinfektues.
- 7-3.2 Ndërtimi dhe/ose rindërtimi dhe blerja e pajisjeve për pikat e shitjeve në mjediset e prodhimit dhe për tregtimin e drejtëpërdrejtë të produkteve
- ambiente dhe pajisje për paketim dhe mbushjen, dhe etiketim;
- ambiente për shitje, përfshirë mjedisë ekspozimi, me të gjitha pajisjet e nevojshme, përfshirë pajisje dhe programme të specializuara kompjuterike dhe orendi.

Kriteret e vlerësimit (IPARD II)

Kriteret e vlerësimit	Investimi është kryer në zonat malore (të përcaktuara)	15 pikë
	Investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme	10 pikë
	Aplikanti (ferma bujqësore) është e certifikuar për prodhim organik në përputhje me ligjin në fuqi për bujqësinë organike	15 pikë
	Aplikanti është femër ose kompani që ka te paktën 30 % te punësuarve femra	15 pikë
	Aplikanti është fermer i ri (jo më shumë se 40 vjeç në momentin e dorëzimit të aplikimit)	15 pikë
	Në bazë të planit të biznesit projekti parashikon hapjen e vendeve të reja të punës	30 pike

Faleminderit për vëmendjen!

